



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr.16/2009
Më 19. 05. 2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Safete Hadërgjonaj, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj, Múfera Şinik dhe Zef Morina.

Mungoi: Slobodan Petroviq.

Pjesëmarrës të tjerë: Besim Zeqiri dhe Sagita Muço – ICO, Lumnije Berisha – ZPRK, Blerina Uka – NDI, Ramadan Klisurica – KDI dhe Ibrahim Krasniqi – konsulent i Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 05. 05. 2009;
3. Raportimi i MEM-it – lidhur me Projektin për termocentralin”Kosova e Re”;
4. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua më heqjen e pikës III të rendit të ditës, për shkak të mospjesëmarrjes së ministres së MEM-it në mbledhje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 05. 05. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 05. 05. 2009 u miratua me vërejtjet e deputetes Safete Hadërgjonaj.

III. Të ndryshme

a) Kryetarja kërkoi nga Fatmir Rexhepi, kryesues i grupit të punës, ta njoftojë Komisionin për punën e bërë në shqyrtimin paraprak të Projektligjit për Gazin Natyror.

Fatmir Rexhepi – E njoftoi grupin e punës se nuk e ka shqyrtuar Projektligjin dhe deklaroi se për shkaqe objektive heq dorë nga udhëheqja e grupit të punës për shqyrtim të Projektligjit për Gazin Natyror.

Ethem Çeku – Propozoi që deputetja Sala Berisha – Shala, të jetë raportuese e grupit të punës për Projektligjin e Gazit Natyror.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. Caktohet, Sala Berisha – Shala raportuese e grupit të punës për Projektligjin për Gazin Natyror.

b) Kryetarja – Kërkoi nga Komisioni ta formojë një grup të punës për Projektligjin e Standardizimit.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. Formohet grupi i punës për Projektligjin e Standardizimit në përbërje: Myzejene Selmani - raportuese, Kaqusha Jashari dhe Safete Hadërgjonaj.

c) Raporti i ART-së

Deputetët shfaqen shqetësuar për mungesën e anëtarëve të Bordit të ART-së, edhe pse ishin ftuar me kohë.

Sala Berisha – Shala – theksoj se kjo çështje duhet të dërgohet në Kryesi të Kuvendit sepse është çështje urgjente të plotësohen Bordet e Agjencive të Pavarura dhe do të ishte një sinjalizim nga Kuvendi edhe për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale që është duke funksionuar pa mandat.

Pas diskutimit të deputetëve: Berim Ramosaj, Safete Hadërgjonaj, Ethem Çeku, Kaqusha Jashari, Fatmir Rexhepi dhe Zef Morina, Komisioni me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër (Safete Hadërgjonaj), nxori këtë

Përfundim

- I. Në mbledhjen e radhës të Komisionit të shqyrtohet Raporti i ART-së edhe pa pjesëmarrjen e Bordit të ART-së

d) Plani i veprimit i Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Integritet Evropian.

Komisioni nxori përfundimin:

- Kërkohej nga ministrat përkatëse (MTI-së, MEF-it, MEM-it dhe MTT-ës) që t'i hartojnë raportet vlerësuese përkatëse sipas kompetencës për shkallën e zgjidhjes së kërkesave – sfidave, që dalin nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian në fushën e Integriteteve Evropiane;
- Raportet t'i përcillen komisionit për ETIETT, më së voni deri më 04.06.2009;

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani